



**Kuvendi i Komunës Klinë**

01Nr. 06-20704 /2024

Datë: 02.07 /2024

Duke u mbështetur në nenin 17 shkronjën a), nenin 40 paragrafi 40.2 shkronjën b) dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjin Për Financat Publike dhe Përgjegjësitë nr.05/L-007 i ndryshuar dhe plotësuar Nr.03/L-048 , sipas Qarkores buxhetore 2025/01, nenit 40 paragrafi 2. Pikën 2 të Statutit të Komunës së Klinës, me rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 07.06.2024 si dhe pas dëgjimeve të mbajtura me publikun, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 28.06.2024 mori këtë:

**V E N D I M**

**Për miratimin**

**E Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2025-2027 për Komunën e Klinës**

1. Miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale për periudhën 2025-2027 si në vijim:

<b>Korniza afatmesme buxhetore 2025-2027</b>	<b>Buxheti aktual 2024</b>	<b>Planifikimi 2025</b>	<b>Vlerësimi 2026</b>	<b>Vlerësimi 2027</b>
Granti i përgjithshëm	6.086.118.00	6.571.819.00	6.951.325.00	7.337.752.00
Granti specifik i arsimit	5.453.127.00	5.953.349.00	6.131.950.00	6.315.908.00
Granti i shëndetësisë	1.673.212.00	1.897.981.00	1.988.325.00	2.082.970.00
Të hyrat vetanake	1.436.260.00	1.495.504.00	1.606.855.00	1.720.536.00
Financimi për shërbimet rezidenciale		250.000.00	200.000.00	200.000.00
<b>Totali :</b>	<b>14.648.717.00</b>	<b>16.168.653.00</b>	<b>16.878.455.00</b>	<b>17.657.166.00</b>

2. Hartimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale, kërkuar me Qarkoren Buxhetore Komunale 2025/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).
3. Pjesë përbërëse e vendimit është Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027 për Komunën e Klinës.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

**Njoftohen:**

- **MAPL;**
- **Kryetari i Komunës;**
- **Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;**
- **Zyra për Informim;**
- **Arkivi.**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Fadil Gashi**